

## Член 50

Помирувачот и арбитерот се должни редовно да го извествуваат Советот за покренувањето, текот и завршувањето на постапката за мирно решавање на работниот спор.

**Права на помирувачот и арбитерот**

## Член 51

Помирувачот и арбитерот имаат право на плата, придонеси и надоместоци од плата согласно со закон и колективен договор.

Средствата од ставот 1 на овој член се обезбедуваат во Буџетот на Република Македонија.

**V. ЕВИДЕНЦИЈА ЗА ПОСТАПКИТЕ ЗА МИРНО РЕШАВАЊЕ НА РАБОТНИТЕ СПОРОВИ**

## Член 52

Советот води евиденција за постапките за мирно решавање на работните спорови.

Евиденцијата содржи особено:

- 1) име, презиме и адреса, односно назив и седиште на страните во спорот;
- 2) име и презиме на помирувачот односно арбитерот;
- 3) предметот на спорот;
- 4) дата на покренување на постапка и
- 5) дата и начинот на завршувањето на спорот.

**VI. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ**

## Член 53

Владата ќе именува директор на Советот во рок од 30 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Советот започнува со работа од денот на именувањето на директорот на Советот.

Изборот на помирувачите и арбитрите и нивниот упис во Именикот, во согласност со овој закон ќе се изврши во рок од три месеца од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Одредбите на овој закон кои се однесуваат на постапката за мирно решавање на работните спорови ќе се применуваат од 1 јануари 2008 година.

## Член 54

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во "Службен весник на Република Македонија".

**L I G J  
PËR ZGJIDHJE TË QETË TË KONTESTEVE TË  
PUNËS****I. DISPOZITAT THEMELORE****LËNDA E RREGULLIMIT**

## Neni 1

Me këtë ligj rregullohet mënyra dhe procedura e zgjidhjes së qetë të kontesteve kolektive dhe të kontesteve të caktuara individuale të punës, zgjedhja, të drejtat dhe obligimet e pajtuesit dhe të arbitrave dhe çështjet tjera me rëndësi për zgjidhjen e qetë të kontesteve të punës.

Procedura për zgjidhjen e qetë të kontesteve të punës, ngrihet dhe udhëhiqet në përputhje me këtë ligj, nëse për kontestin e njëjtë nuk është vendosur në përputhje me rregullat e marrëdhënies të punës.

**NOCIONET THEMELORE**

## Neni 2

Kontest kolektiv i punës, sipas këtij ligji, konsiderohet kontesti me rastin e lidhjes, të ndryshimit, plotësimit ose zbatimit të marrëveshjes kolektive, të realizimit të të drejtave në organizimin sindikal dhe të grevës (në tekstin e mëtejme: kontesti kolektiv).

Palë në kontestin kolektiv, sipas këtij ligji, konsiderohen pjesëmarrësit në lidhjen e marrëveshjes kolektive, në përputhje me ligjin (në tekstin e mëtejme: pala në kontestin).

## Neni 3

Kontesti individual i punës, sipas këtij ligji, konsiderohet kontesti me rastin e anulimit të marrëveshjes për punësim dhe për mospagimin e rrogës më të ulët (në tekstin e mëtejme: kontest individual).

Palë në kontestin individual, sipas këtij ligji, konsiderohen punëtori dhe punëdhënësi (në tekstin e mëtejme: pala në kontest).

## Neni 4

Pajtues, sipas këtij ligji, konsiderohet personi i cili i ndihmon palët në kontestin kolektiv, me qëllim që të lidhin marrëveshje për zgjidhjen e kontestit.

Arbitër, sipas këtij ligji, konsiderohet personi i cili vendos për lëndën e kontestit individual.

**PARIMET THEMELORE****Parimi i vullnetarizmit**

## Neni 5

Pjesëmarrësit në lidhjen e marrëveshjes kolektive, janë të lirë që vullnetarisht të vendosin për pjesëmarrjen e pajtuesit në marrëveshjen kolektive.

Palët në kontest, janë të lira që vullnetarisht të vendosin për fillimin e zgjidhjes së qetë të kontestit, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

**Parimi i tripalësisë, i neutralitetit dhe i paanshmërisë**

## Neni 6

Në procedurën për zgjidhjen e qetë të kontestit të punës, marrin pjesë palët në kontestin dhe pajtuesi, gjegjësisht arbitri, në përputhje me këtë ligj.

Pajtuesi, respektivisht arbitri, është i obliguar që të veprojë në mënyrë neutrale dhe të paanshme ndaj palëve ose ndaj lëndës së kontestit.

**II. KËSHILLI REPUBLIKAN PËR ZGJIDHJEN E QETË TË KONTESTEVE TË PUNËS****THEMELIMI DHE FUSHËVEPRIMI I PUNËS**

## Neni 7

Themelohet Këshilli Republikan për zgjidhjen e qetë të kontesteve të punës, si organ profesional (në tekstin e mëtejme: Këshilli).

## Neni 8

Këshilli kryen punë profesionale të cilat kanë të bëjnë me:

- 1) zgjidhjen e qetë të kontesteve kolektive dhe të kontesteve të caktuara individuale të punës,
- 2) zgjedhjen e pajtuesve dhe të arbitrave,
- 3) mbajtjen e Librit të emrave të pajtuesve dhe të arbitrave (në tekstin e mëtejme: Libri i emrave),
- 4) përkryerjen profesionale të pajtuesve dhe të arbitrave,
- 5) vendimmarrjen për përjashtimin e pajtuesve dhe të arbitrave,
- 6) evidencë për procedurat e zgjidhjes së qetë të kontesteve të punës, dhe
- 7) punë të tjera të përcaktuara me ligjin.

**DREJTORI I KËSHILLIT**

## Neni 9

Me punën e Këshillit udhëheq drejtori. Drejtorin e emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Qeveria).

### III. PROCEDURA PËR ZGJIDHJEN E QETË TË KONTESTEVE TË PUNËS

#### DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

##### Ngritja e procedurës

###### Neni 10

Procedura për zgjidhjen e qetë të kontesteve të punës, ngrihet me parashtrimin e propozimit pranë Këshillit.

Palët në kontest, mund ta parashtrojnë propozimin bashkërisht ose veç e veç.

Propozimi veçanërisht përmban:

1) emrin, mbiemrin dhe adresën, respektivisht emërtimin dhe selinë e palëve në kontest dhe  
2) lëndën e kontestit.

Me propozimin, palët në kontest dorëzojnë dokumentacion, që ka të bëjë me lëndën e kontestit, si edhe emra të dëshmitarëve nëse ka.

###### Neni 11

Nëse propozimin e ka parashtruar njëra nga palët në kontest, Këshilli ia dërgon propozimin dhe dokumentacionin palës tjetër në kontest, dhe e thërret që në afat prej tri ditësh të prononcohet nëse pranon zgjidhje të qetë të kontestit.

Nëse në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni, pala e cila e ka parashtruar propozimin nuk ka marrë përgjigje për pranimin, konsiderohet se propozimi për ngritjen e procedurës nuk është pranuar.

##### Caktimi i pajtuesve respektivisht i arbitrave

###### Neni 12

Pajtuesin respektivisht arbitrin nga Lista e emrave, me marrëveshje e përcaktojnë palët në kontest, me propozim të përbashkët, në afat prej tri ditësh prej ditës së pranimit të propozimit individual.

Nëse palët në kontest, me marrëveshje nuk përcaktojnë pajtues respektivisht arbitër, e përcakton drejtori i Këshillit.

###### Neni 13

Këshilli, ia dërgon propozimin dhe dokumentacionin që ka të bëjë me lëndën e kontestit pajtuesit, respektivisht arbitrit të përcaktuar për kontestin konkret, në afat prej tre ditësh pune nga dita e caktimit të tij.

##### Shpenzimet e procedurës

###### Neni 14

Shpenzimet e pajtuesit respektivisht të arbitrit, i bart Këshilli.

###### Neni 15

Çdo palë në kontest, i bart shpenzimet e veta në drejtim të mënyrës së dëshmipërlimit të ndërsjellë të pjesëmarrësve në zgjidhjen e qetë të kontestit, gjatë dhe në lidhje me udhëheqjen e procedurës për zgjidhjen e qetë të kontestit.

#### KONTESTI KOLEKTIV

##### Pjesëmarrja e pajtuesit në marrëveshjen kolektive

###### Neni 16

Pjesëmarrësit në marrëveshjen kolektive (në tekstin e mëtejme: pjesëmarrësit), mund të parashtrojnë propozim pranë Këshillit, për pjesëmarrjen e pajtuesit në marrëveshjen kolektive, me qëllim të ofrimit të ndihmës dhe pengimit të krijimit të kontestit.

Pjesëmarrësit, mund ta parashtrojnë propozimin bashkërisht ose veç e veç.

Nëse propozimin e ka parashtruar njëri nga pjesëmarrësit, Këshilli e dërgon propozimin dhe dokumentacionin te pjesëmarrësit e tjerë, me kërkesë që brenda tri ditëve të prononcohen, nëse pranojnë pjesëmarrje të pajtuesit në marrëveshjen kolektive.

Propozimi përmban: llojin e marrëveshjes kolektive, pjesëmarrësit, vendin dhe kohën e negociatave, ndërsa propozimi i përbashkët edhe emrin, mbiemrin dhe adresën e pajtuesit.

###### Neni 17

Pajtuesi në procedurën e marrëveshjes kolektive:

1) është i pranishëm në negociatat,  
2) u tregon pjesëmarrësve për propozimet që nuk janë në përputhje me ligjin dhe me rregullat e tjera,  
3) u ofron pjesëmarrësve ndihmë profesionale dhe ndihmë tjetër, dhe  
4) u ndihmon pjesëmarrësve të arrijnë marrëveshje, pa të drejtë të imponojë zgjidhje në kontestin, në përputhje me parimet e zgjidhjes së qetë të kontesteve të punës.

Pajtuesi, është i obliguar që të jetë neutral dhe i paanshëm gjatë negociatave.

##### Kontesti në veprimtaritë me interes të përgjithshëm

###### Neni 18

Në rast të grevës dhe në rast të kontestit në veprimtaritë me interes të përgjithshëm, ose në veprimtaritë në të cilat ndërprerja e punës do të mund ta rrezikonte jetën ose shëndetin e njerëzve ose të shkaktojë dëm me përmasa më të mëdha, palët në kontestin janë të obliguara që ta fillojnë dhe qeta ta zgjidhin kontestin kolektiv në afat prej dhjetë ditësh nga kërkesa e parashtruar.

Veprimtaritë sipas paragrafit 1 të këtij neni, janë veprimtaritë të cilat i kryejnë punëdhënësit në sferën e: elektro-ekonomisë, ekonomisë së ujërave, komunikacionit, radiotelevizionit, themelues i të cilit është Republika e Maqedonisë ose njësitë e vetadministrimit lokal, shërbimet e PTT-së, veprimtaritë komunale, prodhimtaria e produkteve themelore ushqimore, mbrojtja shëndetësore dhe veterinare, arsimit, mbrojtja e fëmijëve, mbrojtja sociale, policia dhe mbrojtja.

###### Neni 19

Në veprimtaritë nga neni 18 i këtij ligji, palët në kontest janë të obliguara që të parashtrojnë propozim të përbashkët, brenda tri ditëve nga dita e lindjes së kontestit.

Nëse palët në kontest nuk parashtrojnë propozim, janë të obliguara që ta lajmërojnë Këshillin.

Nëse palët në kontest nuk parashtrojnë propozim, drejtori i Këshillit me detyrë zyrtare ngre procedurë për pajtim dhe përcakton pajtues nga Libri i emrave.

##### Organi kompetent për pajtimin

###### Neni 20

Procedura për pajtim e kontestit kolektiv, udhëhiqet para Këshillit për pajtim (në tekstin e mëtejme: Këshilli).

Këshillin e përbëjnë nga një përfaqësues nga palët në kontest dhe pajtuesi.

##### Procedura për pajtim

###### Neni 21

Pajtuesi, është i obliguar që ta caktojë seancën brenda tri ditëve prej ditës së pranimit të propozimit dhe të dokumentacionit për lëndën e kontestit, dhe për atë t'i lajmërojë palët në kontest.

Palët në kontest janë të obliguara që ta përcaktojnë përfaqësuesin e vet në Këshill, dhe për këtë ta lajmërojnë pajtuesin, më së voni deri në ditën e seancës së caktuar.

Nëse palët në kontest, nuk e përcaktojnë përfaqësuesin e vet në afatin nga paragrafi 2 i këtij neni, procedurën e pajtimit e udhëheq pajtuesi me kontakte të drejtpërdrejta me palët në kontest.

Përfaqësuesit e palëve në kontest, në seancë i paraqesin qëndrimet dhe propozimet e veta.

## Neni 22

Pajtuessi ka të drejtë që edhe veças, jashtë debatit, të sigurojë informata dhe të dhëna të tjera nga përfaqësuesit e palëve në kontest.

## Neni 23

Pas përfundimit të procedurës së pajtimit, pajtuessi e mbyll debatin dhe me anëtarët e Këshillit miraton rekomandim, për mënyrën e zgjidhjes së kontestit (në tekstin e mëtejme: rekomandim).

## Neni 24

Këshilli, rekomandimin e jep në formë të shkruar, me arsyetim.

Për rekomandimin duhet të votojnë të gjithë anëtarët e Këshillit.

Nëse Këshilli, nuk jep rekomandim brenda pesë ditëve nga dita e mbylljes së debatit, pajtuessi, palëve në kontest mund t'u propozojë rekomandim.

## Neni 25

Rekomandimi, nuk i obligon palët në kontest.

Nëse palët në kontest e pranojnë rekomandimin, lidhin Marrëveshje për zgjidhjen e kontestit.

Nëse lënda e kontestit është marrëveshje kolektive, Marrëveshja paraqet pjesë përbërëse të marrëveshjes kolektive.

Nëse lënda e kontestit nuk është marrëveshje kolektive, Marrëveshja ka fuqinë e barazimit gjyqësor.

## Neni 26

Pala në kontest, e cila nuk do ta pranojë rekomandimin, është e obliguar që brenda afatit prej tri ditësh nga dita e dorëzimit të rekomandimit, t'i tregojë shkaqet për mospranimin e rekomandimit.

Me propozim të pajtuessit, Këshilli mund ta shpallë rekomandimin dhe shkaqet për mospranimin e rekomandimit, në mjetet e informimit publik.

## Neni 27

Procedura për pajtim përfundohet para Këshillit, nëse palët në kontest lidhin Marrëveshje për zgjidhjen e kontestit brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e hapjes së debatit.

## Neni 28

Nëse procedura nuk përfundohet sipas nenit 27 të këtij ligji, pajtuessi e shpërndan Këshillin dhe e vazhdon procedurën e pajtimit, me kontakte të drejtpërdrejta me palët në kontest.

Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, pajtuessi u ndihmon palëve në kontest që të takohen, të debatojnë për lëndën e kontestit dhe të lidhin Marrëveshje për zgjidhjen e kontestit.

## KONTESTI INDIVIDUAL

## Neni 29

Kontesti individual mund të zgjidhet para arbitrit, në përputhje me këtë ligj, nëse lëndë e kontestit është:

- 1) prishja e kontratës për punësim dhe
- 2) mospagimi i rrogës më të ulët.

Nëse ndërmyjet palëve në kontestin individual, rrjedh procedurë gjyqësore në bazë të njëjtë juridike dhe faktike, palët në kontest janë të obliguara që bashkërisht t'i parashtrajnë gjyqit kërkesë për ndërprerjen e procedurës.

## Procedura para arbitrit

## Neni 30

Arbitri është i obliguar të caktojë seancë brenda tri ditëve prej ditës së pranimit të propozimit dhe të dokumentacionit për lëndën e kontestit, dhe për këtë t'i lajmërojë palët në kontest.

Debati mbahet në praninë e palëve në kontest dhe të arbitrit.

Arbitri e hap debatin dhe konstaton nëse personat e ftuar janë të pranishëm në debatin.

Nëse njëra nga palët në kontest mungon paarsyeshëm në debat, arbitri mund ta mbajë seancën në mungesën e asaj, duke e marrë parasysh dokumentacionin që e ka dorëzuar ajo palë.

Çdo palë në kontest mund ta tërheqë propozimin për ngritjen e procedurës para arbitrit, më së voni deri në ditën hapjes së debatit.

## Neni 31

Mbajtja e seancës është publike.

Arbitri mund ta përjashtojë opinionin me kërkesë të palëve në kontest nëse për atë ekzistojnë shkaqet të arsyeshme.

## Neni 32

Arbitri e udhëheq debatin, merr deklarata nga palët në kontest dhe nga personat e tjerë në procedurë, nxjerr prova dhe kujdeset që gjatë procedurës të paraqiten të gjitha faktet relevante për vendimmarrje.

Palët në kontest kanë të drejtë që para arbitrit të prononcohen për lëndën e kontestit dhe të përgjigjen në referimet e palës tjetër në kontest.

Arbitri vendos për shtyrjen e debatit, me detyrë zyrtare ose me kërkesë të palëve në kontest.

Në rastin nga paragrafi 3 i këtij neni, arbitri është i obliguar që të caktojë seancë, më së voni në afat prej pesë ditësh nga dita e shtyrjes së seancës.

## Neni 33

Arbitri, mund të angazhojë ekspertë.

Për ekspertët, në mënyrë përkatëse aplikohen dispozitat e këtij ligji për përjashtimin e arbitrave.

## Neni 34

Palët në kontest kanë të drejtë të mbajnë fjalim përmbyllës në debat.

Nëse arbitri konsideron se lënda e kontestit është debatuar ashtu që mund të marrë vendim, e mbyll debatin.

## Neni 35

Arbitri merr aktvendim për lëndën e kontestit në afat prej 30 ditësh nga dita e hapjes së debatit.

Aktvendimi përmban:

- 1) emrin, mbiemrin dhe adresën, respektivisht emërtimin dhe selinë e palëve në kontestin,
- 2) kumtimin,
- 3) arsyetimin,
- 4) datën e marrjes së aktvendimit dhe
- 5) emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e arbitrit.

Kundër aktvendimit nuk lejohet ankesë.

Aktvendimi është i plotfuqishëm dhe ekzekutiv me ditën e dorëzimit pranë palëve në kontest, ndërsa nëse në aktvendim është konstatuar se veprimi i cili është lëndë e ekzekutimit, mund të realizohet në afatin e lënë, aktvendimi bëhet ekzekutiv me skadimin e atij afati.

## Neni 36

Palët në kontest, janë të obliguara që ta njoftojnë gjykatën për miratimin e aktvendimit nëse procedura para gjykatës është ndërprerë.

## IV. PAJTUES DHE ARBITRA

## ZGJEDHJA E PAJTUESVE DHE E ARBITRAVE

## Neni 37

Pajtuess ose arbitër mund të zgjidhet personi i cili i përmbush kushtet në vijim:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) të ketë përgatitje të lartë profesionale dhe së paku pesë vjet përvojë pune në sferën e marrëdhënieve të punës;

3) të mos i jetë kumtuar sanksioni ndalim i kryerjes së profesionit, i veprimtarisë ose i detyrës;

4) të jetë i denjë për detyrën e pajtuesit gjegjësisht të arbitrit dhe

5) të ketë certifikatë nga Këshilli Republikan, për trajnimin e kryer sipas Programit për trajnimin e pajtuesve dhe të arbitrave.

#### Neni 38

Zgjedhja e pajtuesve dhe e arbitrave, bëhet me anë të shpalljes publike të cilën e publikon Këshilli.

Zgjedhjen nga kandidatët e paraqitur e bën Komisioni për zgjedhjen e pajtuesve dhe të arbitrave (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

Komisioni përbëhet nga dy përfaqësues të Qeverisë, dy përfaqësues të sindikatave reprezentative të themeluara në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe dy përfaqësues të shoqatave reprezentative të punëdhënësve, të themeluara në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Përfaqësuesit e Qeverisë i emëron Qeveria, ndërsa përfaqësuesit e sindikatave dhe të shoqatave të punëdhënësve i emëron Këshilli ekonomik-social, i themeluar për territorin e Republikës së Maqedonisë, me propozim të sindikatave reprezentative dhe shoqatave reprezentative të punëdhënësve – anëtarë të atij këshilli.

Komisioni e zgjedh kryetarin nga radhët e anëtarëve të vet.

Mandati i anëtarëve të Komisionit zgjat katër vjet.

#### Neni 39

Vendimin për zgjedhjen e pajtuesve dhe të arbitrave, Komisioni e merr brenda 15 ditëve prej ditës së skadimit të afatit për parashtrimin e fletëparaqitjes.

Vendimi konsiderohet i miratuar nëse për të kanë votuar shumica e dy të tretave nga anëtarët e Komisionit.

### KOHËZGJATJA E MANDATIT

#### Neni 40

Pajtuesi dhe arbitri zgjidhen për katër vjet dhe mund të rizgjidhen përsëri.

### LIBRI I EMRAVE

#### Neni 41

Cilësia e pajtuesit gjegjësisht e arbitrit, fitohet me ditën e regjistrimit në Librin e emrave.

Në bazë të vendimit për zgjedhjen e pajtuesit gjegjësisht të arbitrit, drejtori i Këshillit miraton aktvendimin për regjistrim në Librin e emrave.

Aktvendimi përmban emrin, mbiemrin, adresën e pajtuesit gjegjësisht të arbitrit.

#### Neni 42

Librin e emrave e mban Këshilli.

Libri i emrave i përmban të dhënat në vijim:

- 1) emrin dhe mbiemrin e pajtuesit gjegjësisht të arbitrit,
- 2) adresën,
- 3) përgatitjen profesionale,
- 4) numrin dhe datën e vendimit për zgjedhje,
- 5) numrin dhe datën e aktvendimit për regjistrim dhe fshirje nga Libri i emrave dhe
- 6) Certifikatën.

#### Neni 43

Pajtuesi dhe arbitri, janë të obliguar që ta paraqesin ndryshimin e të dhënave nga neni 42, paragrafi 2, pikat 2 dhe 4 të këtij ligji, brenda tri ditëve prej ndodhjes së ndryshimit.

#### Neni 44

Cilësia e pajtuesit dhe e arbitrit pushon me fshirjen nga Libri i emrave.

Pajtuesi gjegjësisht arbitri fshihet nga Libri i emrave:

1) nëse në mënyrë plotësuese konstatohet se nuk janë përmbushur kushtet nga neni 37 i këtij ligji,

2) nëse pushojnë të ekzistojnë kushtet nga neni 37, pikat 1, 3 dhe 4 të këtij ligji,

3) pas skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur, nëse nuk rizgjidhet përsëri,

4) nëse refuzon që të përkryhet profesionalisht,

5) nëse e kryen detyrën në mënyrë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme,

6) nëse nuk paraqitet rregullisht në Këshill,

7) nëse paarsyeshëm e prolongon procedurën për zgjedhjen e qetë të kontesteve të punës,

8) me kërkesë të tij,

9) për shkak të humbjes së aftësisë për punë dhe

10) për shkak të vdekjes.

#### Neni 45

Kërkesë për fshirjen nga Libri i emrave mund të parashtrorë Këshilli ekonomik-social ose njëri nga pjesëmarrësit në atë Këshill.

Drejtori i Këshillit miraton aktvendim për fshirjen nga Libri i emrave brenda 15 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës, respektivisht ditës së kuptimit për rrethanim nga neni 44, paragrafi 2 i këtij ligji.

Në rastet nga neni 44, paragrafi 2, pikat 4 deri 7 të këtij ligji, drejtori i Këshillit miraton aktvendim për fshirje, në përputhje me Këshillin ekonomik-social, përveç nëse kërkesën për fshirjen e ka parashtruar ai Këshill.

Aktvendimi për fshirjen nga Libri i emrave është final dhe kundër tij nuk mund të udhëhiqet kontest administrativ, në përputhje me ligjin.

#### Neni 46

Aktvendimi për regjistrim dhe për fshirje, botohet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

### PËRJASHTIMI I PAJTUESIT GJEGJËSISHT I ARBITRIT

#### Neni 47

Palët në kontest munden pranë drejtorit të Këshillit të parashtrorë kërkesë për përjashtimin e pajtuesit respektivisht të arbitrit, edhe atë:

1) nëse e përfaqëson ndonjërin nga palët në kontest ose e ka përfaqësuar në pesë vitet e fundit ndonjërin nga palët në kontestin,

2) nëse është në lidhje gjaku të vijës së parë deri në cilëndo shkallë, ndërsa në vijën anësore deri në shkallën e katërt me ndonjërin nga palët në kontest, respektivisht nëse bashkëshorti ose farefisi nga familja e linjës femërore deri në shkallën e dytë me ndonjërin nga palët në kontest,

3) nëse është në marrëdhënie pune ose anëtarësie, me ndonjërin nga palët në kontest ose marrëdhënia e atillë është krijuar në dy vitet e fundit, dhe

4) nëse ka lidhje me palët në kontest, në cilëndo mënyrë tjetër e cila do të mund të ndikonte në paanshmërinë e tij.

Pajtuesi dhe arbitri, me detyrë zyrtare kujdesen për shkaqet e përjashtimit gjatë procedurës dhe janë të obliguar që për to ta lajmërojnë drejtorin e Këshillit.

Drejtori i Këshillit vendos për përjashtimin e pajtuesit gjegjësisht të arbitrit pas pranimit të lajmërimit nga pajtuesi, gjegjësisht nga arbitri dhe me kërkesë të palëve në kontestin në afat prej tetë ditësh pas kuptimit të shkaqeve të përjashtimit.

Në rast të përjashtimit, procedura për zgjedhjen e qetë të kontestit të punës vazhdon pas zgjedhjes së pajtuesit të ri, gjegjësisht të arbitrit, në përputhje me këtë ligj.

### DETYRAT DHE TË DREJTAT E PAJTUESIT DHE TË ARBITRIT

#### Detyrat e pajtuesit dhe të arbitrit

#### Neni 48

Pajtuesi dhe arbitri janë të obliguar që të veprojnë ndërgjegjshëm dhe sipas njohurive të veta më të mira, me qëllim të zgjidhjes së kontestit ndërmjet palëve në kontestin.

## Neni 49

Пajtuesи dhe arbitri janë të obliguar që të përkryhen profesionalisht.

## Neni 50

Пajtuesи dhe arbitri janë të obliguar që rregullisht ta lajmërojnë Këshillin për ngrитjen, rrjedhën dhe për përfundimin e procedurës për zgjidhjen e qetë të kontestit të punës.

**Тë drejtat e pajtuesит dhe të arbitrit**

## Neni 51

Пajtuesи dhe arbitri kanë të drejtë në frogë, në kontribute dhe në kompensime nga rroga, në përputhje me ligjin dhe me marrëveshjen kolektive.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni, sigurohen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

**V. EVIDENCA PËR PROCEDURAT PËR ZGJIDHJEN E QETË TË KONTESTEVE TË PUNËS**

## Neni 52

Këshilli mban evidencë për procedurat e zgjidhjes së qetë të kontesteve të punës.

Evidenca veçanërisht e përmban:

- 1) emrin, mbiemrin dhe adresën respektivisht emërtimin dhe selinë e palëve në contest;
- 2) emrin dhe mbiemrin e pajtuesит gjegjësisht të arbitrit;
- 3) lëndën e contestit;
- 4) datën e ngrитjes së procedurës dhe
- 5) datën dhe mënyrën e përfundimit të contestit.

**VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

## Neni 53

Qeveria do të emërojë drejtor të Këshillit, në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Këshilli fillon me punë prej ditës së emërimit të drejtorit të Këshillit.

Zgjedhja e pajtuesve dhe e arbitrave dhe regjistrimi i tyre në Listën e emrave, në përputhje me këtë ligj, do të bëhet në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozitat e këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me procedurën e zgjidhjes së qetë të kontesteve të punës, do të zbatohen prej 1 janar 2008.

## Neni 54

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

**1095.**

Vрз основа на член 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

**У К А З****ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ОБЕЗБЕДУВАЊЕ НА ПОБАРУВАЊАТА**

Се прогласува Законот за обезбедување на побарувањата, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 4 јули 2007 година.

Бр. 07-3098/1  
4 јули 2007 година  
Скопје

Претседател  
на Република Македонија,  
**Бранко Црвенковски, с.р.**

Претседател  
на Собранието на Република  
Македонија,  
**Љубиша Георгиевски, с.р.**

**ЗАКОН  
ЗА ОБЕЗБЕДУВАЊЕ НА ПОБАРУВАЊАТА****I. ОСНОВНИ ОДРЕДБИ****Цел на Законот**

## Член 1

(1) Со овој закон се определуваат средствата за обезбедување на побарувањата, начинот на кој тие се определуваат, правилата според кои судот постапува за обезбедување на побарувањата, како и постапувањето на нотарот и постапувањето на извршителот во врска со тоа.

(2) Одредбите на овој закон се применуваат и за обезбедување на побарувања врз брод и врз воздухоплов, ако тоа е определено со закон.

**Значење на одделни изрази**

## Член 2

Одделни изрази употребени во овој закон го имаат следново значење:

1. "Побарување" е право на наплата на паричен износ или право на некое сторување, несторување, трпене или воспоставување на поранешна состојба;
2. "Доверител" е тужител или лице чие побарување се остварува или обезбедува;
3. "Должник" е тужен или лице спрема кое се остварува или обезбедува побарување;
4. "Странка" е тужител и тужен, односно доверител и должник;
5. "Службено лице" е лице вработено во суд кое непосредно презема одделни дејствија за обезбедување на побарувања и
6. "Јавна книга" и "регистри" се книга на тапи, интабулациона книга и катастар на недвижности, по неговото востановување согласно со Законот за премер, катастар и запишување на правата на недвижностите (во нагаташниот текст: катастарот), Централниот регистар на Република Македонија, Централниот депозитар на хартии од вредност, Заложниот регистар, Единствениот регистар на даночни обврзници, Единствениот регистар за стечај, Судскиот регистар, Единствениот регистар на иматели на сметки, Регистарот на моторни и приклучни возила и евиденција на регистрираните моторни и приклучни возила и други регистри востановени со закон.

**Итноста на постапката за обезбедување**

## Член 3

- (1) Постапката за обезбедување е итна.
- (2) Судот е должен предметот да го земе во работа најдоцна во рок од три дена од денот на приемот на барањето.

**Поведување на постапка за обезбедување на побарувањата**

## Член 4

(1) Постапката за обезбедување на побарувањата (во нагаташниот текст: постапка за обезбедување) се поведува по барање (тужба или предлог) на тужителот, односно доверителот.

(2) Постапката за обезбедување во прв степен ја води и одлуките ги донесува судија поединец, а во втор степен одлучува совет од тројца судии.

(3) Одлуките во постапката за обезбедување судот ги донесува во форма на решение или заклучок.

(4) Со решение се одлучува по барањето за обезбедување на побарување.

(5) Со заклучок му се издава налог на службеното лице за спроведување на одделни дејствија и се одлучува за други прашања на управување со постапката.